



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Mars 2023

Nr: 87

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË MAT, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 3 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Z. Ervin Hysa, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Mat

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Mat, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 27.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Mat.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 3 Mars 2023

Nr: 87
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Mat, për raportimin e veprimtarive publike”

“Ditën e sotme në sallën e këshillit bashkiak Mat, kryetari i bashkisë z. Agron Malaj, priti në një takim grupin e peshkatarëve nga Ulza dhe Uraka, ku shprehen disa pakënaqësi në lidhje me shoqatën e peshkimit që operon në liqenin Ulëz dhe Shkopet, për shkak të rritjes së tarifës nga 70 (shtatëdhjetë mijë lek të vjetra) në 150 (njëqind e pesëdhjetë mijë lek të vjetra)”.

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=569726405195003&set=pcb.569726551861655>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi u shqyrtua paraprakisht çështja, u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 27.2.2023, bashkisë Mat i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 1.3.2023, bashkia Mat bën me dije se: *“Në sqarim të konstatimit tuaj për aktivitetin e zhvilluar nga kryetari i bashkisë me banorë të Njësisë Administrative Ulëz, lidhur me problematikën e tyre ju sqarojmë se ky aktivitet, nuk ishte i planifikuar për tu zhvilluar, por duke u ndodhur para faktit që banorë të Njësisë Administrative Ulëz ndodheshin në ambientet e bashkisë dhe kërkonin me insistim takim me kryetarin e bashkisë lidhur me shqetësimet e tyre. Të ndodhur në këto rrethana është realizuar dhe takimi i konstatuar nga ana juaj.”*

Nga verifikimi i të dhënave, fakteve dhe rrethanave të marra në shqyrtim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se bashkia Mat, nuk ka qenë në kushtet e organizatorit të këtij takimi.

Referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, aktiviteti i kryera nga kryetari i bashkisë Mat nuk përbën veprimtari publike të ndaluar pasi evidentoj se kjo veprimtari përkon me përmbushjen e detyrave funksionale të kryetarit të bashkisë.

Mosraportimi nuk cënon në thelb parashikimet ligjore mbi raportimin e veprimtarive publike.

Në këto kushte, në mungesë edhe të informacionit nga ana e bashkisë Mat, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Mat, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Ervin Hysa, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Mat.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Mat, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 3 Mars 2023

Nr: 87
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Mat, për raportimin e veprimtarive publike”